



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:186069

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05598122

PKR.nr.283/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje nga gjyqtarja Sulltane Hoti, kryetare e trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arxhenita Vokshi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E.D, për shkak të veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.100/2023 të dates 31.08.2023, pas mbajtjes së seancës shqyrtimit fillestar me datë 15.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit A.H, të akuzuarit E.D, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.B.G, të dëmtuarës A.A me përfaqësuesin e saj me autorizim av.F.P, në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, me datë 17.04.2024 mori dhe publikisht në prezencën e palëve, shpalli ndërsa me datë 22.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.D, nga i ati i Z... dhe nëna K..., e gjinisë P..., i lindur me në Prishtinë, me vendbanim në rrugën L.M, "P.Gj.P" nr.66, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punon-kuzhinier, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 29.09.2022, rreth orës 14:50 minuta, në rrugën "Hajrullah Zymi" në Fushë Kosovës, në barnatoren "A.. Pharmacy", i akuzuari E.D duke e ditur se paraja është e falsifikuar e ka vënë në qarkullim kartëmonedhën në vlerë prej 100 (njëqind) euro me numër serik SS03729436520 duke blerë produkte farmaceutike në vlerë prej 8.90 euro, ndërsa për kthim kishte pranuar shumën e parave në origjinal prej 91.1 euro, pronë e të dëmtuarës A.A, e cila kartëmonedhë sipas ekspertimit rezulton të jetë e falsifikuar.

- me këtë ka kryer veprën penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7; 17; 21; 38; 39; 43; 44; 69; 70; 71 dhe 72 të KPRK-së dhe neneve 242; 364, 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM I CILI ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT I ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË

- Ashtu që i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje gjashtë (6) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **700€ (shtatëqind Euro)**, e të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi,

- Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgim duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.

-Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve të gjykatës, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind Euro (**100€**) në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumë prej pesëdhjetë Euro (**50€**), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në mbështetje të nenit 276 par.2 nënpar.2.5 të KPPRK-së, si dhe nenit 296 par.6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndaj të akuzuarit urdhërohet: Konfiskimi i sendeve dhe atë: Kartëmonedha e falsifikuar në shumën prej njëqind (100) euro, me numër SS03729436520.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës, A.A, t'ia paguajë dëmin në shumën prej njëqind (100) euro, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.100/2023 të datës 31.08.2023, ndaj të akuzuarit E.D, për shkak të veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 15.04.2024, ku prezantuan Prokurori i shtetit A.H, i akuzuari E.D, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.B.G, e dëmtuara A.A me përfaqësuesin e saj me autorizim av.F.P.

Pas leximit të aktakuzës Prokurori i Shtetit, të akuzuarit menjëherë iu dha mundësia e deklarimit të tij lidhur me fajësinë i cili deklaroi, se është fajtor i veprës penale që i ngarkohet sipas aktakuzës dhe ndihet i penduar, ka shtuar se nuk e ka ditë se me çfarë shoqërie ka qenë i rrethuar, shprehi gatishmëri ta kompensoj dëmin tek pala e dëmtuar dhe premtoj se vepra të tilla nuk do të përsëriten në të ardhëm nga ana ime.

Mbrojtësi i të pandehurit av.B.G lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se i mbrojturi i tij është konsultuar mjaftueshëm me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, kërkoj që të aprovohet pranimi i fajësisë, pasi që i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare, pas konsultimit të mjaftueshëm më të si mbrojtës andaj gjykata pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë posaçërisht lehtësuese po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e hershëm të fajësisë si në institucionin policor, në prokurori, dhe sot para gjykatës, po ashtu si rrethanë

lehtësuese të merret edhe mosha e re e tij, dhe pendimin e thellë gjë të cilën e ka cekur edhe prokurori në aktakuzë, i njëjti është mbajtes i familjes, gatishmërinë e tij që ta kompensojë dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar, ndërsa gjykata të mos bazohet në rrethanat rënduese tek e kaluara e tij, pasi që mbi ato raste ende qëndron prezumimi i pafajësisë, në fund i propozoj gjykatës që në matjen dhe lartësinë e dënimit gjykata t'i ketë parasysh këto rrethana lehtësuese, dhe që ndaj të njëjtit t'i shqiptoj një dënim sa më të lehtë kryesisht dënim me kusht ose në rastin më të favorshëm nëse gjykata shqipton me dënim me burgim të njëjtin ta zëvendësoj me gjobë, konform dispozitave ligjore, dhe po ashtu hoqi dorë nga seanca e dënimit, pasi që është deklaruar për të gjitha rrethanat.

Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit duke pasur parasysh se pranimi i fajësisë është në përputhje me provat e paraqitura në aktakuzë, e po ashtu nuk ka asnjë shkelje të dispozitave ligjore për pranim të fajësisë edhe janë plotësuar të gjitha kushtet, i propozoj gjykatës që ta miratoj këtë pranim të fajësisë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës A.A Av.F.P deklaroi se pranimi i fajësisë mbështetet në prova të cilat gjinden në shkresat e lëndës prova këto të siguruara në mënyrë të ligjshme andaj pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të vendos sipas ligjit, ndërsa i propozoj gjykatës që në rastin e përpilimit të aktgjykimit ta detyroj të pandehurin që t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shumën prej 100 euro.

E dëmtuara A.A deklaroi se e përkrah fjalën e përfaqësuesit të saj.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i akuzuari E.D, pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, mbrojtësi dhe i dëmtuari, gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë të të akuzuarit, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej, Gjykata nuk administroj prova por vlerësoj se në veprimet e të akuzuarit E.D formësohen të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

Gjykata, rikujton se sipas nenit 22 të KPRK-së, dashja është element subjektiv i veprës penale e cila mund të nxjerrët nga rrethanat faktike të rastit. E nga rrethanat e rastit konkret dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, po ashtu bazuar edhe në shkresat e lëndës dhe nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari kemi arritur në përfundim se i akuzuari i lartcekur, veprën e lartcekur penale, e ka kryer me dashje të drejtpërdrejtë apo dashje direkte.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti i ekspertimit i lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë AKF/2022-4328/22-4201 i datës 27.12.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me numer 2022-AE-1406 i datës 30.09.2022; Fotodokumentacioni, si dhe nga shkresat tjera të cilat gjenden në dosjen e kësaj lënde, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale të lartcekur. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi qe gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si

rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë, kompensimin ndaj të dëmtuarës, sinqeritetin e tij deklarues, po ashtu moshën e tij të re, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj të cilin dënim konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i ka zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej shtatëqind (700) Euro si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenin 69 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të taksës për Programin e Kompensimit e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.2 të Ligji nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin e parave është marrë konform nenit 296 par.6 të KPRK-së si dhe nenit 276 par.2 nënpar.2.5 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e dëmit nga i akuzuari ndaj palës së dëmtuara mbështetet në nenin 462 par.2 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.283/23 datë 22.04.2024

Zyrtare ligjore
Arxhenita Vokshi

Kryetarja e trupit gjykues,
Sulltane Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.